

## **Takim informues dhe konsultativ në Lezhë mbi shërbimin civil dhe sfidat e administratës publike**

Institucioni i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), në bashkëpunim me Kuvendin dhe dy Komisionet Parlamentare: “Për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike” dhe “Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale”, me mbështetjen edhe të Zyrës së OSBE-së, mbajtën në Lezhë, në ambientet e bibliotekës së qytetit, një tryezë konsultative mbi shërbimin civil dhe sfidat e administratës publike.



Komisionerja, znj. Lefterije Lleshi (Luzi), falënderoi Ambasadorin e OSBE-së, drejtuesit dhe anëtarët e komisioneve parlamentare, si dhe përfaqësuesit e Bashkisë Lezhë, për angazhimin e tyre në këtë tryezë diskutimesh mbi të ardhmen e shërbimit civil në Shqipëri.



Gjatë fjalës së saj, Komisionerja u ndal në çështje që lidhen me sfidat e njësisive të vetëqeverisjes vendore në ndërtimin e strukturave organizative dhe administrimin e shërbimit civil, garantimin e paanshmërisë gjatë proceseve zgjedhore, digjitalizimin e proceseve mbikëqyrëse, ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë, si dhe rolin e shqyrtimit administrativ në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, z. Ulsi Manja vlerësoi nismën e Komisionerit për të forcuar dialogun ndërinstytucional dhe falënderoi edhe deputetët e të dy komisioneve parlamentare për prezencën e tyre në këtë tryezë të dedikuar shërbimit civil dhe sfidave të administratës publike.

Gjatë sesionit të parë mbajtën fjalë përshëndetëse edhe Ambasadori i OSBE-së në Shqipëri, z. Michel Tarran, si dhe Kryetari i Bashkisë së Lezhës, z. Pjerin Ndreu.

Në vijim, gjatë sesionit të dytë, u prezantuan projektet prioritare të Institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me fokus digjitalizimin e procesit të mbikëqyrjes, nevojën për përmirësime ligjore dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.



Në përfundim, të tryezës konsultative, u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional edhe me partnerët ndërkombëtarë për ndërtimin e një administrate publike profesionale, të qëndrueshme dhe në shërbim të qytetarëve.